

Kreditimi Rural i Kosovës SH.P.K., është Institucion Mikrofinanciar i cili me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të stafit ka planifikuar mbajtjen e trajnimeve si më poshtë.

SHPALLJE

Në bazë të kësaj shpallje ftohen kompanitë/individët e interesuara për paraqitjen e ofertave të tyre për mbajtjen e trajnimeve sipas temave dhe kushteve të specifikuara në vijim.

Objekti i shpalljes: Mbajtja e trajnimeve me qëllim të fuqizimit të stafit menaxhues.

Nr	Titulli i trajnimit	Përshkrim i llojit të trajnimit	Grupi i synuar	Numri i grupeve	Numri i pjesëmarrësve në grup	Kohëzgjatja në ditë/muaj	Numri total i ditëve/muajve
1	Lidership	Trajnimi i fokusuar në zhvillimin e aftësive strategjike dhe drejtuese, të rrisin performancën organizative, të forcojnë kulturën e kompanisë dhe të udhëheqin me efektivitet në mjedise komplekse dhe dinamike.	Menaxher	1	3	2 dite	2 dite
2	Gjuhe angleze	Nivel i avancuar i kursit të gjuhës angleze që përfshinë komunikimin e rrjethshëm në gjuhën angleze të biznesit.	Menaxher	1	3	1-2 muaj	1-2 muaj

Oferta për aplikim duhet të përmbajë:

1. Të dhënat për kompaninë/institucionin/individin (mbajtësi i trajnimit),
2. Të dhënat kontaktuese (adresën elektronike, numrin e telefonit, webfaqe, etj),
3. Detaje rreth moduleve të trajnimeve,
4. Referencat për punë të ngjashme (të preferuara ato nga sektori financiar)
5. Certifikata e kompanisë nëse ofertuesi është person legal,
6. Të dhënat për trajnerët (CV-të), përfshirë certifikatat që dëshmon se është i certifikuar si trajner apo ka përvojë relevante në fushat përkatëse,
7. Oferta financiare dhe afati për kryerjen e punës si më lartë (e preferueshme nga muaji Prill)
8. Çmimet duhet të jenë me TVSH dhe për ditë të trajnimit.
9. Oferta mund të bëhet për të gjitha modulet ose vetëm për module specifike.
10. Trajnimet janë parapare të mbahen në klase dhe në hapësirat e KRK ose online.

Afati i dorëzimit të ofertave: nga dt. **17.03.2026** deri **23.03.2026**. Afati i implementimit të trajnimeve: Prill-Qershor 2026

Kompanitë e interesuara mund t'i dërgojnë ofertat e tyre në adresën elektronike: krk_imf@krk-ks.com apo në zyrën e KRK, Rr.Behije Dashi, Objekti D, pn, Prishtinë.

Nëse keni nevojë për sqarime shtesë mund të na shkruani në adresën elektronike: krk_imf@krk-ks.com

Zgjedhja e kompanisë fituese do të bëhet në bazë të vlerësimit të ofertave nga komisioni duke marrë në konsiderim kualitetin, çmimin dhe afatin e propozuar për mbajtjen e trajnimeve.

Titulli i email-it tuaj duhet të përmbajë mbishkrimin “Aplikim për trajnime”